REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 01/17
Datë/Datum. 24.02.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH. Nr. 01/17

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, në përbërje prej: z. Tefik Sylejmani - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga OE NP"Risamont" – nga Prishtina,lidhur me aktivitetin e prokurimit:"Furnizim me koka kabllovike", me nr. të prokurimit:KEKO 16/407/136 të iniciuar nga autoriteti kontraktues Korporata Energjetike e Kosovës, më: 13.02.2017, mori këtë :

V E N D I M

I. **Aprovohet**, si e pjesërisht e bazuar ankesa e OE ankues NP"Risamont" – nga Prishtina,lidhur me aktivitetin e prokurimit:"Furnizim me koka kabllovike", me nr. të prokurimit:KEKO 16/407/136 të iniciuar nga autoriteti kontraktues Korporata Energjetike e Kosovës.

II.Vërtetohet, vendimi i autoritetit kontraktues – Korporata Energjetike e Kosovës lidhur me njoftimin për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit: :"Furnizim me koka kabllovike", me nr. të prokurimit:KEKO 16/407/136 .

III. Autoriteti kontraktues në afat prej 10 ditësh të njoftoj Panelin Shqyrtues për të të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV.Mos respektimi i këtij vendimi detyron panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të LPP-ës të ndërmarr masa ndaj autoritetit kontraktues,që nuk respekton vendimin e panelit shqyrtues të parapar me këtë ligj

V. Meqenëse pretendimet ankimore të operatorit ekonomik ankues "Risamont" - Prishtinë janë pjesërisht të qëndrueshme, konform nenit 118 të LPP-së,i kthehet sigurimi i ankesës.OE në afat prej 60 ditësh janë të obliguar të parashtrojnë kërkesë për tërheqjen e mjeteve në të kundërtën këto mjete barten në buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Autoriteti kontraktues Korporata Energjetike e Kosovës ka bërë njoftimin për kontratë me dt.18.11.2016 në KRPP, procedurë e hapur, vlera e kontratë e mesme,furnizim, afati për ofertim 01.12.2016 ku të njëjtën datë është bërë hapja ofertave.

Kriter për dhënie të kontratës ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.Për këtë aktivitet të prokurimit kanë ofertuar gjithsej 3 (tre)OE.

AK ka formuar komisionin e vlerësimit të ofertave, sipas komisionit vlerësues është rekomanduar për kontratë OE:"Inline Enginering".

Në shenjë mos pajtimi me rekomandimin e AK për dhënie të kontratës OE pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit me datë 04.01.2017 deponon ankesë në OSHP me pretendimin se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 69,70 të LPP-ës si dhe nenin 40.9 të UOPP.

Ankesa aprovohet si pjesërisht e bazuar.

Pas pranimit të ankesës OSHP me datë 16.01.2017 autorizon ekspertin shqyrtues z.Fazliu për trajtimin e pretendimeve ankimore i cili me datë 20.01.2017 i dorëzon panelit shqyrtues raportin e ekspertizës me konstatime dhe rekomandim që të aprovohet ankesa e OE ankues.

Me 24.01.2017 AK njfton panelin se nuk pajtohen me raportin e ekspertit shqyrtues.

Me datë 20.01.2017 OE ankues njofton panelin se të njëjtit pajtohen me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues në seancën dëgjimore të mbajtur me dt.13.02.2017,ku të pranishëm ishin përfaqësuesi i AK,përfaqësuesi i OE ankues dhe eksperti shqyrtues,paneli shqyrtoi shkresat e lëndës si:dosjen e tenderit,ankesën me pretendime ankimore raportin e ekspertit shqyrtues të prokurimit,përgjigjet lidhur me këtë raport të ekspertit si nga ana e AK dhe OE ankues si dhe bër dëgjimin e palëve ku në fillim fjala ju dhe përfaqësuesit të OE ankues z.Rexhepi i cili deklaroj:

Një ndër kriteret bazë të vlerësimit ka qenë edhe deklarata e garancionit. Pasi që ne kemi kërkuar qasje në dokumente e kemi vërejt se deklarata e garancionit nuk ekziston, dhe për këtë arsye kemi vlerësuar se është bërë vlerësim jo i drejt.

Sa i përket pretendimit të dytë ne ju kemi referuar interpretimit të KRPP-së, i cili pas sqarimeve të sotme për tenderin në fjalë më nuk është i vlefshëm dhe pajtohem me këtë.

Te pjesa specifikave teknike poshtë nën vulë dhe nën nënshkrim e ka një shkrim që thuhet "garancioni sipas FDT" që i referohet fleta e të dhënave të tenderit, që realisht në kuotime të çmimeve FDT nuk ka fare, andaj një garancion i tillë mungon.

Ne kemi cek edhe në ankesë se nëse është e vlefshme atëherë pse të shpenzojmë letër dhe material të veçantë nëse mundet të mbulohet gjithçka me deklaratë.

Për ndryshe qëndrojmë pranë ankesës dhe pretendimeve ankimore dhe i propozojmë panelit që të aprovoj ankesën tonë.

Në vazhdim fjala iu dha përfaq1ësuesit të AK-KEK z.Syla i cili deklaroj:
Ne prapë nuk pajtohemi me konstatimin e ekspertit, pasi nuk është specifikim teknik por është certifikatë e pajtueshmërisë ku është pajtuar OE dhe në fund ceket "garantojmë 12 muaj sipas FDT" dhe këtë e kemi marr si bazë për garancion për specifikimet teknike që i sjell.
Konsiderojmë se oferta e këtij OE është valide.

Kryetari i panelit pyeti përfaqësuesin e AK se në kërkesat e përshtatshmërisë – profesionale teknike, a keni parashikuar deklaratën mbi garancionin e produkteve.
Në përgjigje z.Syla deklaroj:
Në faqe 4 neni 3 parashikohet zakonisht ku kërkohet afati liferimit dhe garancioni, mirëpo në formular të KRPP ceket se garancioni duhet të jetë sipas kërkesave të AK, kërkesa jonë ka qenë deklaratë për garancionin e produkteve të ofruara që OE e ka plotësuar me një thënie se do i plotësojnë kërkesat sipas të dhënave të dosjes së tenderit.
Te fleta kuotimit janë paraparë liferimi dhe përputhshmëria teknike si dhe garancioni.
Ne si AK në rast vlerësojmë se kemi vepruar drejt sipas dokumentacionit të ofruar nga OE, duke u nis se kuotimi i çmimeve aplikohet për treg të gjerë, edhe pse me ligjin e ri tani jemi obliguar edhe kuotimet ti publikojmë.
Qëndrojmë pranë vendimit të AK-së dhe i rekomandojmë panelit që të vërtetoj vendimin e AK si të bazuar.

Në vazhdim fjala iu dha ekspertit shqyrtues z.Fazliu i cili deklaroj:
Unë i sqaroj panelit se pretendimi kryesor ka të bëjë me garancionin që është potencuar – kërkuar në dosjen e kuotimit të çmimit, siç potencoj edhe vet AK deklarata e garancionit dhe si e tillë nuk është ofruar nga OE i rekomanduar për kontratë, dmth nuk ka deklaratë e garancionit nga OE i rekomanduar për kontratë.
Ndërsa sa i përket shkrimit që i referohet AK në dokumente tjetër në dosje të tenderit nuk mund të jap konstatim.
Paneli shqyrtues nga shkresat e lëndës dhe pas dëgjimit të palëve gjeti se pretendimi ankimor i OE ankues lidhur me shkeljet e nenit 40.9 të UOPP nuk qëndron sepse përzgjedhja e fituesit në rastin kur çmimet janë identike vlen parimi ai i cili është i pari për nga koha më i fortë nga e drejta do të vlen pas hyrjes në fuqi të UOPP, në rastin konkret ofertat janë dorëzuar para hyrjes në fuqi të UOPP dhe komisioni ka vepruar drejtë me shumicën e votave të anëtarëve të komisionit vlerësues për këtë edhe OE ankues është pajtuar në seancë dëgjimore.
Lidhur me pretendimin se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 69 dhe 70 të LPP-ës për panelin shqyrtues qëndron pjesërisht ky pretendim ankimor, sepse OE i rekomanduar për kontratë nuk ka dorëzuar të veçantë por ka dorëzuar një deklaratë nga cila është marr nga forma standarde e DT e nënshkruar dhe e vulosur me theks të veçantë **Garancioni i pajisjeve** **është sipas kërkesave** të DT,për panelin shqyrtues kjo deklaratë e mbulon kërkesën e AK e cila ka qenë garanciaoni 12 muaj për pajisjeve të ofruara dhe nuk ndryshon në aspektin material këtë ofertë.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe atë: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave,njoftimi mbi dhënien e kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, përgjigjja e AK-së mbi raportin e ekspertizës si dhe parashtresa e OE ankues lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues gjeti se AK ka vepruar në pajtim me dispozitat e nenit 59.4 të LPP-ës dhe nenit 40.9 të UOPP.

Andaj Paneli shqyrtues, duke u bazuar në nenin 117 të LPP-së, si dhe duke u mbështetur në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike :
Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur
nuk mund të ushtron ankesë,
por për kompensim dëmi në afat prej 30 ditësh,
pas pranimit të këtij vendimi, mund të ngritë
kërkesë-padi në Gjykatën Themelore - Prishtinë
Departamenti për Çështje Administrative.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues
Tefik Sylejmani